



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1151/2 prot

Datë 13.05.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*EL-GJO-2006*” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar, Mallra*”, me Nr. *REF-99158-03-25-2024*, me objekt “*ARTIKUJ USHQIMORE*”, me fond limit 2.333.333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve 0 -5 Vjeç, Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “*EL-GJO-2006*” SHPK me NIPT J66902033R, me adresë: *Lagjja “Tre Heronjt”, Rruga “Pal Engjelli”, Zona kadastrale 8593, nr pasurie 10/630, Shkodër.*

Autoriteti Kontraktor: Shtëpia e Fëmijëve 0 -5 Vjeç, Shkodër
Adresa: Lagja “Skenderbeg”, Shkodër.

Në datën 10.05.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 1151/2024, datë 10.05.2024 dhe numër elektronik A/2024/4073, datë 10.05.2024, e operatorit ekonomik “*EL-GJO-2006*” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar, Mallra*”, me Nr. *REF-99158-03-25-2024*, me objekt “*ARTIKUJ USHQIMORE*”, me fond limit 2.333.333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve 0 -5 Vjeç, Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*EL-GJO-2006*” Sh.P.K, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 3 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose*

enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “KREATX” Sh.P.K kundërshton me anë të ankesës si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Ne formularin e Vetëdeklarimit sipas shtojces nr.8 keni deklaruar si subjekt mbështetes Martin Vata per te cilin nuk keni paraqitur një Formular te veçantë te Vetëdeklarimit, sipas percaktimeve te DST,ku citohet si me poshte: Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 13.05.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri